



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 134 Datë 17.09.2012

MBI

**KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME
SHUMICË) DHE SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A
(FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2012
DERI MË 31.12.2014**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, dhe nenit 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 gërma ”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, i ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 date 23.06.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 17.09.2011, pasi u njoh me peopozimin e KESH sh.a. me nr. 1906 Prot., date 4/05/2012 si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike të ERE, mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2014”,

Konstatoi se :

Palet e kesaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe OSSH/FPP, jane të licensuara nga ERE përkatësisht:

- “CEZ Shpërndarje” sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.9 datë 25.01.2008, i ndryshuar,
- “KESH” sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 11 datë 23.06.2006, i ndryshuar.

Vendosi:

1. Miratimin e kontratës për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ

Shperndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2014 me ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin e efektet nga data 1 Janar 2012 deri më datë 31 Dhjetor 2014.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Teksti i ndryshimeve te kontrates:

1- Ne piken 1, te nenit 3, te Kontrates fjalia e pare, ndryshohet si vijon:

“Shitesi do te siguroje energjine elektrike ne perputhje me sasine e energjise elektrike te planifikuar per efekt te perlllogaritjes se tarifes se furnizuesit publik me shumice per periudhen e trete rregullatore 2012 – 2014, ne kohen dhe ne sasine sic do t’ia tregoje Bleresi Shitesit sipas percaktimeve te Modelit dhe Rregullave te Tregut.”

2- “Pika 8.3.i e Kontrates, riformulohet:

“i- Ne rastin e importit te nje sasie me te madhe, KESH sh.a. do t’i kompensoje CEZ Shperndajes, kete diference pozitive me energji elektrike deri ne fund te muajit m+2. Ne rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhes m+2, KESH sh.a. eshte i detyruar te kompensoje CEZ Shperndarje sh.a. ne muajin m+3, me vleren monetare qe i korrespondon kostove reale te shkaktuar dhe te identifikuara nga CEZ Shperndarje per sigurimin e kesaj sasie te energjise elektrike.

3- “Pika 8.3.ii e Kontrates, riformulohet:

“ii- Ne rastin e importit te nje sasie me te vogel se humbjet reale ne rrjetin e shperndarjes, CEZ Shperndarje do te kompensoje kete sasi te energjise elektrike te siguruar nga KESH sh.a., deri ne fund te muajit m+2. Ne rast se kompensimi nuk kryhet brenda periudhes m+2, CEZ Shperndarje sh.a. eshte i detyruar te kompensoje KESH sh.a. ne muajin m+3, me vleren monetare qe i korrespondon kostove reale te shkaktuar dhe te identifikuara nga KESH sh.a. per sigurimin e kesaj sasie te energjise elektrike.

4- Pika 8.3.iii, shfuqizohet.

5- Neni 11 ndryshohet si vijon:

“Cmimi per levrimin e energjise elektrike sipas kesaj kontrate do te jete ai i aprovuar nga ERE sipas vendimeve perkatese per percaktimin e tarifes se Furnizuesit Publik me Shumice per periudhen e trete rregullatore”

6- Neni 15, pika 1, pas fjaleve “ne favor te Shitesit” te shtohen fjalet “garancine bankare ne vleren monetare qe i korrespondon 1/2 te sasise mesatare mujore te energjise elektrike te planifikuar.....”

7- Neni 22, pika 1, ndryshohet si vijon:

“Kjo kontrate dhe secili nga kushtet ketu, do te hyje ne fuqi pas miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2012 deri 31 Dhjetor 2014”.

8- Ne shtojcen 1 te Kontrates, shtohet termi i meposhtem:

“**Kosto Reale** – ka kuptimin e te gjitha shpenzimeve qe identifikohen nga kompania per sigurimin e energjise elektrike nga burimet perkatese perfshire edhe gjithe kostot shtese te paparashikuara (overdraft) si dhe cdo vleresim mbi impaktin e transaksionit ne treguesit e eficenses se perdorimit te rezervave ujore”